REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 314 Prot

Maliq, më 15.01.2025

PROJEKT- VENDIM – NR. 12

Për

" Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë "

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 ''Për vetëqeverisjen vendore'' neni nr.9 , pika 1.1. gërma (a) , neni 25, neni 54 shkronja (k) , neni 4 pika 1 dhe 2, neni 7, neni 16 i ligjit nr.75/2019 ''Për rininë'', neni 1 i ligjit nr.7850 datë 29.7.1994 'Kodi Civil të Republikës së Shqipërisë i kërkoj Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë Planin Lokal të Veprimit për Rininë sipas tekstit bashkëlidhur;
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë, Agjencia e Shërbimeve Mbështetëse (Zyra e Turizmit, Rinisë dhe Trashëgimisë Kulturore) si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashki;
3. Ky vendi hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " , i ndryshuar.

Konceptoi : J. Xhialli – Sekretrar i Përgjithshëm

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT DHE ARTIT
ZYRA E REKREACIONIT TURIZMIT DHE RINISË

Nr. 314 Prot. Maliq 15/01/2025

RELACION
PËR KËSHILLIN BASHKIAK
MBI MIRARIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT TË RINISË VITI (2025-2028) NË BASHKINË E MALIQIT

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!

Ne zbatim te Ligjit nr.75/2019 "Per Rininë" dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, i cili ka si qëllim përcaktimin e veprimeve, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe finacimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti, bazuar ne*"Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029"*, si dokument ku bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve, *Strategjinë e Bashkimit Europian për Rininë 2019-2027,* e cila është korniza për bashkëpunimin e BE-së për politikat rinore, *Agjenda Kombetare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026,* janë integruar dhe veprimtaritë që lidhen me grup moshën 15-19 vjeçare të parashikuara, në *Agjenden Kombetare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026,* mbështetur në parimet dhe qëllimin e *Strategjisë Kombëtare të Arësimit 2021-2026* e cila synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në menyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin, *Agjenda Digjitale e Shqiperisë dhe e Planit të Veprimit 2022-2206, "Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025"*, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, bazuar në Ligjin 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", dhe gjithë kuadrin tjetër ligjor

plotësues në këtë dokument, ku synohet realizimi i objektivave e prioriteteve të vendosura për vititet 2025-2028.

Plani Lokal i Veprimit i Bashkisë Maliq për të Rinjtë, u bë i mundur nga bashkepunimi i Bashkisë Maliq me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (C.R.C.A) falë mbështetjes së Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët, në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime të Integruara Rinore në Qarkun Korçë".

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2025-2028, ka si qëllim avancimin dhe rritjen e angazhimit të të gjithë të rinjve dhe të rejave që jetojnë në Maliq, duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve aktive, që synojnë përfshirjen e të rinjve në jetën sociale, politike, ekonomike dhe vendimarrëse të komunitetit ku jetojnë. Ky plan synon t'i vendosë të rinjtë dhe të rejat në qendër të vëmendjes të punës dhe përpjekjeve të Bashkisë përgjatë 3 viteve të ardhshme, duke i konsideruar ata një komponent të rëndësishëm të avancimit qytetar dhe me qëllim rritjen e pjesmarrjes së tyre në vendimarrjen vendore.

Misioni i këtij Plan Veprimi është përmirësimi i gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje, si dhe fuqizimi i të rinjve që jetojnë, punojnë dhe studiojnë në territorin që i përket Bashkisë Maliq ,pra me specifikisht ky dokument strategjik synon

-të identifikojë problemet, nevojat dhe prioritetet e të rinjve në Bashkinë Maliq dhe

-propozon zgjidhjet e mundshme ose fushat e ndërhyrjes, nëpërmjet mënyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara, për të adresuar problematikat e dala.

Metodologjia e ndjekur në këtë plan konsiston në 6 etapa të ndryshme si me poshte ku për secilën etapë është marrë në konsideratë çdo element, që nga identifikimi i prioriteteve, takimet konsultuese me të rinjtë dhe aktorët përkatës deri tek faza e prezantimit publik ku të gjitha këto veprime janë shoqëruar me takime, dokumenta dhe foto përkatëse .

1. *ETAPA 1-Faza përgatitore;*
2. *ETAPA 2-Identifikimi i prioriteteve;*
3. *ETAPA 3-Bashkëpunimi me strukturat e Bashkisë Maliq;*
4. *ETAPA 4-Konsultim me përfaqësuesit e Bashkisë Maliq;*
5. *ETAPA 5-Prezantimi publik;*
6. *ETAPA 6-Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak*

Më pas ky plan është plotësuar me të dhena demografike dhe vijon me paraqitjen 4 prioriteteve kryesore të cilat janë pasqyruar në një matricë me detaje sipas objektivave, afateve dhe aktorëve perkatës për të mundësuar realizimin e tyre ku synohet, ngritja e shërbimeve të reja dhe rrjetëzimi i

tyre,koordinimi i shërbimeve dhe ngritja e kapaciteteve të strukturave dhe fuqizimi i tyre ku bashkëngjitur kemi dhe politikat e dhe prioritetet ;

1. **PRIORITETI 1 - Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës (infrastukturë dhe investimet)**
2. **PRIORITETI 2 - Punësimi dhe sipërmarrja rinore**
3. **PRIORITETI 3 - Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje**
4. **PRIORITETI 4- Sport, kulturë (hapësira publike për të rinjtë)**

Bashkia Maliq ka zhvilluar një plan rinor gjithëpërfshirës për të fuqizuar dhe mbështetur të rinjtë në komunitet, me një qëllim të qartë, objektiva strategjike , vizion dhe metodologji . Plani Lokal i Rinisë synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirëse inkurajues për të rinjtë ,dhe mundësish të ndryshme për ta.

Qëllimi i bashkë Maliq është të krijojë një mjedis mbështetës dhe fuqizues që mundëson zhvillimin e të rinjve , duke i pajisur ata me aftësi dhe mjete të nevojeshme për të qenë të suksesshëm dhe për të dhënë kontribute pozitive për komunitetin e përbashkët.

Për të arritur këtë ,Plani Lokal i Rinisë(2025-2028) mbështetet në 4 politika dhe prioritete sic janë përmendur më lart .

Së pari, ai synon të përmirësojë edukimin dhe punësimin e të rinjve, për të ofruar mundësi të edukimit formal, jo-formal dhe informal, programe për ndërtimin e aftësive dhe nxitjen e partneriteteve në institucionet arsimore dhe bisneseve.

Së dyti, prioritet është promovimi i shëndetit dhe mirëqënies ,duke zbatuar nisma që kanë prioritet mirëqënien fizike dhe mendore .

Së treti ,plani synon të nxisi angazhimin dhe pjesmearrjen e të rinjve, duke i përfshirë në mënyrë aktive të rinjtë në procese vendimarrëse dhe duke ofruar mundësi për angazhim qytetar.

Së katërti, plani synon të fuqizojë të rinjtë duke ofruar mundësi për shprejhje artistike dhe kulturore dhe angazhim mjedisor, duke nxitur rritjen e tyre personale, mirëqenien dhe pjesëmarrjen aktive në komunitet.

Krijimi i buxheteve për këtë plan do të jetë sipas kërkesave që dalin nga të rinjtë organizatat dhe aktorë apo donatorë të ndryshëm për projekte dhe monitorimi i tij do të jetë sipas prioriteteve të caktuara dhe në afatet e caktuara.

Vizioni i bashkisë Maliq është të krijojë një komunitet gjithëpërfshirës ku të rinjtë të fuqizohen , mbeshteten dhe angazhohen në mënyrë aktive në formësimin e së ardhmes së tyre .

Bashkia synon një mjedis edukues që promovon barazinë dhe kultivon qytetarinë e përgjegjeshme, mes të rinjve dhe e vendos theksin tek puna rinore cilësore dhe me standarte, me të rinjtë.

Për të siguruar suksesin e Planit Lokal Rinor dhe një adresim sa më të mirë të nevojave është nëjekur një metodologji gjithëpërfshirëse ku janë zhvilluar fokus grupe me të rinjtë, intervista me palet e interesuara dhe një rishikim të kuadrit ligjor dhe të politikave në lidhje me të rinjtë. Kjo qasje siguron që plani të jetë i formuar, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nismat ekzistuese.

Nëpermejt Planit Lokal të Rinisë, bashkia synon të krijojë një mjedis edukues që u mundëson të rinjve të ecin përpara, të rriten dhe të kontribuojnë në përmirësimin e komunitetit të përbashkët.

Plani Lokal i Veprimit të rinisë(2025-2028) i bashkisë Maliq ofron një platformë fuqizimi për të rinjtë me të rinjtë dhe nga të rinjtë duke e bërë bashkinë tonë një vënd ku të rinjtë të shpalosin potencialin e tyre dhe të jetojnë në harmoni dhe prosperitet.

Qëllimi i këtij plani është të shërbejë si një nga dokumentat më të rëndësishëm, udhëzues në përmbushjen e detyrimeve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë të rinjtë në të gjithë territorin e bashkisë Maliq me shtrirje nga çdo Njësi Administrative në qytet e zonat rurale, për ti fuqizuar ata e për ti dhenë krahë e jetë potencialit të tyre.

Plani Lokal i Veprimit të Rinisë i kushton rëndësi të veçantë fuqizimit të të rinjve ndërmjet edukimit joformal, nxitjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të punës cilësore me të rinjtë ashtu siç shprehet qartë në gjithë korpusin e hartimit të tij, në partnershipi strategjik nga bashkëpunimi me Qëndrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri(C.R.C.A) me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrit të Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi: Specialiste e Rinisë

*Todila Hajdini*_____

Përgjegjësi i Sektorit të

Trashëgimisë Kulturore Turizmit dhe Artit

*Tomor Festimi*_____

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

_____